



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

01 Nr. /2024

Datë: 20.09.2024

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 5, 6 pika 1.2, nenit 8 pika 1.2, nenit 14 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 13 dhe 14 i Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale dhe në dispozitat e Statutit të Komunës së Gjakovës 01nr110/04- 29365 i datës 30.12.2022, pas diskutimit lidhur me pikën 6 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme Komunale me numra të parcelës P-70705029-01637-1 përmes procedurës së shprehjes së Interesit, e miratoi këtë:

V E N D I M

Paraprak

për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës miraton vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale përmes procedurës së shprehjes së Interesit, në parcelën me numër P-70705029-01637-1 Z.K Gjakovë -Qytet me sipërfaqe prej 356m² e cila është në pronësi të Komunës së Gjakovës
2. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme Komunale të cekur në pikën e 1 të këtij Vendimi është afatgjatë në kohëzgjatje prej nëntëdhjetenëntë (99) viteve.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të Pronës Komunale të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është ndërtimi i objekteve sipas destinimit të përcaktuar në dokumentet e Planifikimit Hapësinor duke e funksionalizuar pronën komunale dhe duke e arritur përfitimin Ekonomik të Komunës nga Pronat Komunale.
4. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes shprehjes së interesit në harmoni me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
6. **Vendimi iu dërgohet:**
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini.
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
 - Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë .
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit.



Arbëneshaj Kuqi

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA GJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	19.09.2024
Për:	Arbënesh Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda:	Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale me numër të parcelës P-70705029-01637-1 përmes procedurës së shprehjes së interesit

Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 58 shkronja (h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5, 6 pika 1.2, nenit 8 pika 1.2 dhe 14 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, dispozitave të Statutit të Komunës së Gjakovës të miratuar me datë 28.12.2022, Kryetari i Gjakovës me datë 19.09.2024 e parashtron në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

P R O P O Z I M V E N D I M

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës të miratojë vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme përmes procedurës së shprehjes së interesit, për pronën me numër të parcelës P-70705029-01637-1, Z.K Gjakovë - Qytet, në sipërfaqe prej 356 m² e cila është në pronësi të Komunës së Gjakovës.
2. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës të paluajtshme komunale si në piken një (1) të këtij vendimi është afatgjatë, prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vitesh.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës është ndërtimi i objekteve sipas destinimit të përcaktuar në dokumentet e planifikimit hapësinorë, duke funksionalizuar pronën komunale dhe duke e arritur përfitimin ekonomik të komunës nga prona komunale.
4. Procedura për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës realizohet përmes shprehjes së interesit në harmoni me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
5. Pjesë përbërëse e këtij Propozim vendimi është:
 - Certifikata mbi pronësinë
 - Kopja e planit

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životte Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70705029-01637-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	13960-
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	19.09.2024 - 10:15
Komuna / Opština / Municipality:	GIAKOVË / DIAKOVICA / GJAKOVË
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastal Zone:	Gjakovë-Qyteti / Gjakovë-Qyteti / Gjakovë-Qyteti
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastal Office:	GIAKOVË / DIAKOVICA / GJAKOVË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA						
Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On
P-70705029-01637-1	PARCELE / PARCELA / PARCEL	/ /	Urban	356	261/10-Ndërrje fshatë;Aktivizimi C.ur.416/06;dt.07.12.09;Gjy.k.Kom.Gjakovë	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i kualitet Mesto zvanio Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
Qyteti				

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENIA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcesë Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcesë Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualitet i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m²)
1	1okë Ndërtimore/Gradjevinisko zemljište/Construction land	Oborr/Dvoriste/Back Yard		253
2	1okë Ndërtimore/Gradjevinisko zemljište/Construction land	Stenje/Ndërtim/Kuca/Zgrada/House-Building		103

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hodësitë e adresës Pojednostavni adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershtkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posejdim individual Individualna Drzavina Single possessor	Komuna e Gjakovës	600597986	/ / /		NENA TEREZE	1/1	261/10-Ndërtje fizike;Aktivizimi C.ar.416/06/di.07.12.09;Gjyq.K om.Gjakovë	




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT \ KOPJA PLANA \ COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija \ Municipal Cadastral Office : GJAKOVË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona \ Cadastral Zone : Gjakovë Qytet

Njësia \ Jednica \ Unit	Tipi \ Vrsta \ Type	Sipërfaqja \ Poveršina \ Area m ²
P - 70705029 - 01637 - I	Parcelë \ Parcela \ Parcel - shëpi	103.0
	Parcelë \ Parcela \ Parcel - oborr	253.0



Punoi \ Obradio \ Created :
Data \ Data \ Date : 19.09.2024
Koha \ Vreme \ Time : 10:30:24



